

PLEURAD XHAFA

Monument për Dështimin

Inaugurimi i monumentit / E enjte, 28 Janar 2016, ora 09.00

Tiranë, trotuari përballë godinës së Presidencës (Bulevardi Dëshmorët e Kombit)

Artisti Pleurad Xhafa në bashkëpunimin e tij të parë me MAPS - Museum of Art in Public Space, i dhuron qytetit të Tiranës një monument kushtuar një nga ngjarjeve më të debatuar të historisë bashkëkohore Shqiptare. Çështja “Gërdeci”.

Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nënkontraktorëve privat prej disa kohësh kryenin çmontimin e municioneve ruso-kineze të mbetura nga periudha komuniste brenda fabrikës së demontimit të armëve të fshatit Gërdec të komunës Vorë, Shqipëri. Në shkelje të kontratave dhe nëpërmjet dokumenteve të rreme nga palët kontraktuese, në fabrikë, municionet çmontoheshin me mjete rrethore në kushte të mjerueshme nga persona të pakualifikuar, si gra dhe fëmijë të cilët banonin pranë fabrikës. Për pasojë në mesditën e orës lokale, të së shtunës date 15 mars 2008, 14 kilometër nga qendra e Tiranës, një shpërthim i madh morri jetën e 26 personave dhe plagosi 300 të tjerë. Thua jse 5 vjet më vonë, Gjykata e lartë e Shqipërisë e klasifikoi ngjarjen e shpërthimit në fabrikën e Gërdecit një “Aksident teknologjik”.

A ishte vërtet një aksident teknologjik duke marrë parasysh kushtet në të cilat kryheshin demontimet e municioneve? Apo mos ndoshta kjo çështje tejkalon autoritetin e një gjykate të brishtë?!

Duke ndjekur gjurmët e kësaj ngjarjeje vepra “Monument për Dështimin”, mishërohet tek një pemë e prerë, tashmë një objekt i vdekur me rrënje të gjatë e të fshehur nën asfaltin e Bulevardit Dëshmorët e Kombit, 15 km nga krateri i Gërdecit. Pleurad Xhafa e çon vëmendjen sërisht tek ky bulevard ku qëndrojnë institucionet më të rëndësishme të vendit dhe janë konsumuar ngjarje nga më emblematiket e historisë Shqiptare. I ngritur fare pak centimetra nga trotuari përballë godinës së Presidencës, ky trung, dikur një dëshmitar i së shkuarës me vendosjen e pllakadës së bronxit shëndrrohet në një monument, simbol i dështimit. Përballë këtij monumenti shikuesi gjendet i papërgatitur ashtu si të papërgatitur u gjenden familjarët e viktimave të Gërdecit, në goditjen përfundimtare të çekiçit të drejtësisë.

Rreth artisti

Pleurad Xhafa është një artist vizual i cili jeton dhe punon në Tiranë, Shqipëri. Pasi përfundoi studimet në Bologna, ai u diplomua me një MFA në Akademinë e Arteve të Bukura në Bologna, në 2012. Nëpërmjet punës së tij artisti tregon vëmendje për trashëgiminë e çështjeve konceptuale dhe dokumentative në art, duke i dhënë rëndësi peizazhit të kërkimit dhe praktikave në artin bashkohor. Ai ka marrë pjesë në shfaqje ndërkombëtare në grup duke përfshirë: Every revolution is a throw of dice, Genoa, Italy (2006); Onufri Prize, Albania (2008); Tirana Biennale, (Satellite Project) Albania (2009); Berlin Biennale, Germany (2010); Lavoro/Work/Vore, Udine, Italy (2013); Ardhja Award, Tirana, Albania (2013); Shame on you, Celje, Slovenia (2015); Les Rencontres Internationales, Paris, France (2016). Puna e tij është nderuar me çmimin e parë në konkursin Ardhja, 2013 nga Tirana Institute of Contemporary Art (T.I.C.A)



Rreth MAPS - Muzeu i Artit në Hapësirën Publike

MAPS - Muzeu i Artit në Hapësirën Publike është një platformë artistike e themeluar në vitin 2014 me qëllim promovimin e hulumtimit të artit bashkëkohor që ka si teatër, hapësirën publike në të gjitha format dhe derivatet e saj. Një muze i shpërthyer, i cili i mundëson artistëve të ftuar përballjen çdo herë me zona të ndryshme të qytetit, që përfaqësojnë konotacionehistorike dhe bashkëkohore të ikonografisë qytetit. MAPS është një muze që pushton / angazhohet / transformon përmes prodhimit të ekspozitave / shfaqjes së videove/ konferencave, fokusi i të cilave është gjithmonë diskutimi dhe dialogu me një territor të qytetit dhe problematikat sociale e urbane të tij. Sepse takimi me artin mund të shkaktojë tronditjen e një revolte, ose anasjelltas arti është një revoltë sepse përmban në vetvete emocionin e njerëzve dhe vendeve që takohen.

